



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin
“TIF Helexpo” Selanik/Greqi

Data e organizimit:
7-15 shtator 2024
Adresa: Selanik, Greqi

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të prodhimeve të parafabrikuara nga sektori i drurit, metalit dhe betonit, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, regjistrimin e 15 subjekteve pjesëmarrëse të prodhimeve të parafabrikuara nga sektori i drurit, metalit dhe betonit, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e ndërtimit të standës, udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit të materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 09.08.2024. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës (Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet.

Për këtë aktivitetet sipas kritereve në vijim dhe vlerësimin të pikëve do të përzgjidhen 15 subjekte:

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt
 - 3 pikë për 2 produkte
 - 5 pikë për 3 produkte
 - 7 pikë për 4 produkte dhe
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 5 pikë
 - Gjuhë Greke 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 4 pikë
 - Gjuhë Greke 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet/shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2023, maksimum 10 pikë:
 - Shtetet e BE-së 5 pikë
 - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
 - Shtetet tjera 2 pikë.

Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:

- FSC CoC 3 pikë dhe
- Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panair apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
 - 1 deri në 3 panair 3 pikë dhe
 - 4 deri në 6 panair 5 pikë.

Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2023, maksimumi 10 pikë:

- 0 - 500.000 euro 4 pikë
- 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
- > 1,000.000 euro 10 pikë.

Më 05.08.2024, në ora 13:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 09.08.2024 në e-mail adresën: Export.Kies@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit: mint.rks-gov.net dhe kies.rks-gov.net apo në e-mail adresën: Export.Kies@rks-gov.net